



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P. 643/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.10.2019 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

**Objekt:** Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “SI.SI-AL” shpk në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-23517-05-23-2019, me objekt: “Blerje bojë sinjalistike horizontale dhe dylen”, me fond limit 1.860.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 06.06.2019, nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Fier.

**Ankimues:** “Trinity Trade Company” shpk.  
Rruga “Alqi Boshnjaku” (ish-Rr. Reshit Çollaku) Nd.38, H.6, Ap.3  
Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Fier.  
Lagjia: “11 Janari”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Fier..

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1, të nenit 63, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 24.05.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-23517-05-23-2019, me objekt: “Blerje bojë sinjalistike horizontale dhe dylen”, me fond limit 1.860.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 06.06.2019, nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Fier.

II.2. Në datën 06.06.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 28.06.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “SI.SI-AL” shpk	1193000.00 lekë	skualifikuar
2. “Trinity Trade Company” shpk	1241700.00 lekë	kualifikuar

3. “Zeqiri” shpk	1345000.00 lekë	kualifikuar
4. “Maliq Haka” person fizik	1366000.00 lekë	kualifikuar
5. “Deutschcolor” shpk	1398200.00 lekë	kualifikuar
6. “Sign & Road Safety Solutions” shpk	1432000.00 lekë	skualifikuar
7. “Murati D” shpk	1478000.00 lekë	kualifikuar
8. “Hest” shpk	1579000.00 lekë	kualifikuar
9. “I.D.K Konstruksion” shpk	1660000.00 lekë	kualifikuar
10. “Bolt” shpk	1858000.00 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 15.07.2019, pas marrjes në shqyrtim dhe pranimit të ankesës së operatorit ekonomik “SI.SI-AL” shpk, autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësimin e procedurës si më poshtë:

1. “SI.SI-AL” shpk	1193000.00 lekë	kualifikuar
2. “Trinity Trade Company” shpk	1241700.00 lekë	kualifikuar
3. “Zeqiri” shpk	1345000.00 lekë	kualifikuar
4. “Maliq Haka” person fizik	1366000.00 lekë	kualifikuar
5. “Deutschcolor” shpk	1398200.00 lekë	kualifikuar
6. “Sign & Road Safety Solutions” shpk	1432000.00 lekë	skualifikuar
7. “Murati D” shpk	1478000.00 lekë	kualifikuar
8. “Hest” shpk	1579000.00 lekë	kualifikuar
9. “I.D.K Konstruksion” shpk	1660000.00 lekë	kualifikuar
10. “Bolt” shpk	1858000.00 lekë	kualifikuar

II.5. Në datën 15.07.2019, operatori ekonomik “Trinity Trade Company” shpk është njoftuar elektronikisht për rivlerësimin e procedurës së prokurimit, si dhe kualifikimin e operatorit ekonomik.

II.6. Operatori ekonomik “Trinity Trade Company” shpk, në datën 18.07.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së shoqërisë “SI.SI-AL” shpk në procedurën e prokurimit, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

[...]

AK- Ndërrmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Fier, më datë 06.06.2019, ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje bojë bojë sinjalistike dhe dylient”, me fond limit: 1.860.000 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Më datë 28.06.2019, AK bën rivlerësimin e parë të OE dhe nga mesazhi i ardhur në llogarinë tonë tek SPE, vëmë re që kanë marrë pjesë në garë dhe kanë dhënë ofertën e tyre 10 OE, nga të cilët janë kualifikuar 8 OE, dhe oferta e shoqërisë tonë është e para e kualifikuar, si më poshtë:

Operatorët ekonomike	Vlerat e Ofertuara	
“SI.SI-AL” shpk	1193000.00	skualifikuar
“Trinity Trade Company” shpk	1241700.00	kualifikuar
“Zeqiri” shpk	1345000.00	kualifikuar
“Maliq Haka” person fizik	1366000.00	kualifikuar

<i>“Deutschcolor” shpk</i>	<i>1398200.00</i>	<i>kualifikuar</i>
<i>“Sign &amp; Road Safety Solutions” shpk</i>	<i>1432000.00</i>	<i>skualifikuar</i>
<i>“Murati D” shpk</i>	<i>1478000.00</i>	<i>kualifikuar</i>
<i>“Hest” shpk</i>	<i>1579000.00</i>	<i>kualifikuar</i>
<i>“I.D.K Konstruksion” shpk</i>	<i>1660000.00</i>	<i>kualifikuar</i>
<i>“Bolt” shpk</i>	<i>1858000.00</i>	<i>kualifikuar</i>

*Por, më datë 15.07.2019, na vjen një mesazh i dytë nga AK, me një vlerësim të dytë të ri, si më poshtë:*

<i>Operatorët ekonomike</i>	<i>Vlerat e Ofertuara</i>	
<i>“SI.SI-AL” shpk</i>	<i>1193000.00</i>	<i>kualifikuar</i>
<i>“Trinity Trade Company” shpk</i>	<i>1241700.00</i>	<i>kualifikuar</i>
<i>“Zeqiri” shpk</i>	<i>1345000.00</i>	<i>kualifikuar</i>
<i>“Maliq Haka” person fizik</i>	<i>1366000.00</i>	<i>kualifikuar</i>
<i>“Deutschcolor” shpk</i>	<i>1398200.00</i>	<i>kualifikuar</i>
<i>“Sign &amp; Road Safety Solutions” shpk</i>	<i>1432000.00</i>	<i>kualifikuar</i>
<i>“Murati D” shpk</i>	<i>1478000.00</i>	<i>kualifikuar</i>
<i>“Hest” shpk</i>	<i>1579000.00</i>	<i>kualifikuar</i>
<i>“I.D.K Konstruksion” shpk</i>	<i>1660000.00</i>	<i>kualifikuar</i>
<i>“Bolt” shpk</i>	<i>1858000.00</i>	<i>kualifikuar</i>

*nga i cili shohim që është kualifikuar edhe operatori ekonomik “SI.SI-AL” shpk, i cili në vlerësimin e parë tëo datës 28.06.2019, rezultonte i skualifikuar!*

*Shoqëria jonë ka një përvojë tëo madhe në pjesëmarrjen e saj në prokurimin publik dhe sidomos në objektin e tenderit në fjalë. Nisur nga kjo përvojë e gjatë si dhe nga standartet e larta tëo mallrave tëo kërkuara nga AK në këtë procedure në jemi tëo sigurtë që operatori ekonomik “SI.SI-AL” shpk ka mangësi në dokumentacionin e ofertës tëo dorëzuar në këtë tender.*

*Në mbështetje tëo Ligjit dhe nisur nga interesi i shoqërisë tonë në këtë procedurë për tëo fituar kontratën dhe duke qënë se operatori ekonomik i kualifikuar “SI.SI-AL” shpk rezulton me çmim më tëo ulët se shoqëria jonë, ne kundërshtojmë kualifikimin e këtij operatori ekonomik, për arsytet e mëposhtme: Për operatorin ekonomik “SI.SI-AL” shpk, shoqëria jonë në këtë ankesë ngre këto pretendime:*

*1- Në DT, kërkesat e veçanta për kualifikim, pika 2.1 f, kërkohet: “d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.”.*

*a) Operatori ekonomik “SI.SI-AL” shpk nuk e plotëson këtë kërkesë sipas ligjit, dhe përcaktimit të mësipërm, pasi dokumenti i paraqitur nga ky OE, nuk tregon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të fundit (Prill 2019), të energjisë elektrike,*

*b) Operatori ekonomik “SI.SI-AL” shpk nuk e plotëson këtë kërkesë sipas ligjit, dhe përcaktimit të mësipërm, pasi dokumenti i paraqitur nga ky OE, nuk tregon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të fundit (Prill 2019), të energjisë elektrike për kontratat e këtij operatori ekonomik sipas të gjitha vendeve të ushtrimit të aktivitetit të shënuara në ekstraktin e QKB-së.*

*Theksojmë: KVO- ja duhet të kishte bërë verifikimet përkatëse në lidhje me vërtetimin e paraqitur nga ky OE.*

*Ftojme anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA-së) të caktuar nga titullari i autoritetit kontraktor të bëjnë verifikimet përkatëse.*

*2- Në DT, kërkesat e veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.3.1, kërkohet: “2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se 700.000 lekë pa tvsh (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontrates, që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.”.*

*Për këtë pikë operatori ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtëm:*

*a- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasit e mallrave të furnizuara, ose*

*b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.”.*

*Operatori ekonomik “SI.SI-AL” shpk, me dokumentacionin e paraqitur, nuk e plotëson këtë kërkesë sipas Ligjit dhe DT, sepse:*

*a) Në furnizimet e paraqitura nga ky OE, nuk ka artikuj të ngjashëm me ato të preventivit të këtij tenderi në vlerën e kërkuar nga AK.*

*b) Artikujt të konsideruar të ngjashëm, pjesë e kontratave apo faturave të paraqitura nga ky operator ekonomik nuk e plotësojnë vlerën e kërkuara nga AK, prej 40% të fondit limit.*

*Ftojme anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA-së), të caktuar nga Titullari i autoritetit kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse.*

*3. Operatori ekonomik “SI.SI-AL” shpk, nuk plotëson një ndër kërkesat kryesore për kualifikim, konkretisht pikeën 2.1.1 a, të kriterëve të veçanta për kualifikim, ku kërkohet: “Objekti i veprimtarisë së QKB duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.”.*

*Ky operator ekonomik, sipas Ekstraktit të QKB-së, nuk ka të përfshirë në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit (bojra).*

*4. Operatori ekonomik “SI.SI-AL” shpk, nuk plotëson kërkesat për kualifikim, konkretisht pikën 2.3.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim, ku kërkohet: “Çertifikatë e menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015 për objektin që prokurohet (e cila duhet të jetë e përkthyer në shqip dhe e noterizuar).”.*

*Ky operator ekonomik nuk gëzon besueshmërinë e plotë për realizimin e kontratës në kohën, sasinë dhe cilësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, prandaj ky operator ekonomik duhet të ishte skualifikuar nga ana e KVO-së.*

*KSHA i caktuar për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “SI.SI-AL” shpk pranë AK, nuk e ka shqyrtuar sipas ligjit atë ankesë. KSHA-ja mund ti ketë quajtur devijime të vogla mangësitë e shumta që ka ky operator ekonomik në dokumentacionin e ofertës, duke shkelur ligjin.*

*I kujtojmë KSHA-së përkatëse ligjin, si dhe disa vendime të KPP-së për raste të ngjashme si psh: Vendimin 230/2019, datë 18.04.2019 ku ndër të tjera thuhet: “ Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.*

*Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.”.*

*Paraqitja pranë autoriteteve kontraktore e dokumentacionit të kërkuar në dokumentat e tenderit pas hapjes së ofertave është i pavlefshëm, me përjashtim të rastit kur kemi të bëjmë me sqarime të cilat kërkojnë nga vetë autoriteti kontraktor në mbështetje të nenit 53, pika 1 të LPP.*

*Përfundimisht i kujtojmë anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës tonë që të bazohen:*

*- Në dokumentat e tenderit - Kapitulli II, Seksioni 1, pika 1.1 Hartimi i ofertës, “Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta do të refuzohen si të papranueshme.*

*Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”.*

*Ndërsa në nenin 53, pika 3, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”.*

*Pra nisur nga përcaktimet ligjore, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.*

*Pra, nisur nga sa më lart cituam, operatori ekonomik “SI.SI-AL” shpk, nuk ka arritur të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe në parashikimet ligjore dhe rrjedhimisht oferta e tij duhet të refuzohet nga ana e Titullarit të AK.*

*Z. Kryetar i AK, vendimi i KVO- së, për kualifikimin e operatori ekonomik “SI.SI-AL” shpk është i nxituar, i gabuar, dhe në shkelje të LPP dhe VKM për RRPP, rrjedhimisht, ky vendim duhet ndryshuar nga ana Juaj.*

*Prandaj në bazë të LPP, të VKM për RRPP të DT dhe argumentave dhe fakteve të dhëna nga ana jonë kërkojmë: “Shfuqizimin e vendimit të KVO- së për kualifikimin e operatori ekonomik “SI.SI-AL” shpk, duke e skualifikuar atë.*

II.6. Me anë të shkresës nr.6427/4 prot., datë 24.07.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimes, duke e refuzuar atë me pretendimet si më poshtë:

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës fillimisht u njoh me ecurinë e procedurës “Blerje boje sinjalistike horizontale dhe dilyent”.*

*Në datën 28.06.2019 autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin për këtë procedurë dhe ka shpallur klasifikimin e ofertave, ku subjekti “SLSI-Al” sh.p.k. është skualifikuar dhe në vend të parë është renditur operatori ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k.*

*Në datë 08.07.2019 operatori ekonomik “SLSI-Al” sh.p.k. ka paraqitur ankesën pranë Bashkisë Fier, ku në mbështetje të nenit 63, të Ligjit të Prokurimeve nr..9346 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, është pezulluar procedura dhe është shqyrtuar ankesa e këtij operatori.*

*Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, KSHA e ngritur me urdhërin nr.6107/2 prot, datë 08.07.2019 vendosi ti japë të drejtë pretendimeve të operatorit ekonomik “SLSI-Al” sh.p.k.*

*Si rrjedhojë KVO, bëri rivlerësimin e ofertave dhe riklasifikoi ofertat, duke nxjerre fitues të kësaj procedure operatorin ekonomik “SLSI-Al” sh.p.k.*

*Në datën 18.07.2019, pranë autoritetit tonë kontraktor Bashkia Fier ka mbërritur ankesa e operatorit ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k. duke ankimuar rivlerësimin e bërë nga KVO për këtë procedurë.*

*Në vijim, KSHA e ngritur me urdhërin nr.6427/2 prot, datë 18.07.2019, pasi u njoh me ankesën e këtij operatori, konstatoi se shoqëria “Trinity Trade Company” sh.p.k ka ankimuar rivlerësimin e bërë nga KVO e datës 15.07.2019 sepse:*

*1. Vlerëson të padrejtë operatorit ekonomik “SLSI-Al” sh.p.k bërë nga KSHA për këtë procedurë për arsyen se: “Operatori ekonomik “SLSI-Al” sh.p.k nuk tregon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të fundit (Prill 2019) të OSHEE.*

*Nga verifikimi i dokumentacionit të subjektit “SLSI-Al” sh.p.k të dorëzuara për këtë procedurë rezulton se nga ky subjekt është paraqitur vërtetimi me nr.11088/1 prot date.24.05.2019, nga OSHEE ku subjekti i ka të shlyera detyrimet e maturuara të energjisë përfshirë dhe muajin Prill 2019.*

*Përsa më sipër, pretendimi i shoqërisë “Trinity Trade Company” sh.p.k për këtë pikë nuk qëndron.*

*2. Vlerëson të padrejtë kualifikimin e operatorit ekonomik “SLSI-Al” sh.p.k bërë nga KSHA për këtë procedurë për arsyen se: operatori ekonomik “SLSI-Al” sh.p.k nuk tregon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë të muajit Prill 2019 për kontratat e këtij operatori ekonomik sipas të gjitha vendeve të ushtrimit të aktivitetit të shënuara në ekstraktin e OKB.*

*Nga verifikimi i dokumentacionit të subjektit “Si.Si-Al” sh.p.k. të dorëzuara për këtë procedurë rezulton se nga ky subjekt është paraqitur vërtetimi me nr.11088/1 prot datë 24.05.2019 nga OSHEE ku subjekti i ka të shlyera detyrimet e maturuara të energjisë përfshirë dhe muajin Prill 2019. Gjithashtu KSHA pa me vëmendje dhe ekstraktin e QKB të operatorit ekonomik “SLSI-Al” sh.p.k dhe vëren se tek rubrika “Vënde të tjera të ushtrimit të aktivitetit” në ekstraktin e QKB të tij janë të regjistruar dy makina me të njëjtën adresë me atë të adresës kryesore; “1. Tiranë Kashar KASHAR Kamion Man F18 me targë AA 029 KE; 2.Tiranë Kashar KASHAR AVP Bremach '735” me targë AA 032 KM.”.*

*Përsa më sipër, pretendimi i shoqërisë “Trinity Trade Company” sh.p.k për këtë pikë nuk qëndron.*

3. Vlerëson të padrejtë kualifikimin e operatorit ekonomik "SLSI-AL" sh.p.k bërë nga KSHA për këtë procedurë për arsye se: "Furnizimet e mëparshme nuk plotësojnë vlerën e kërkuar prej 700.000 lekë pa TVSH."

Nga verifikimi i dokumentacionit të subjektit "SLSI-AL" sh.p.k të dorëzuara për këtë procedurë rezulton se nga ky subjekt është paraqitur fatura tatimore shitje me tvsh nr. 25 datë 15.11.2017 me nr.serial 47080626 me subjektin "Modeste" sh.p.k. në vlerën pa TVSH prej 19.239,44 euro.

Për këtë arsye, pretendimi i operatorit ekonomik "Trinity Trade Company" sh.p.k. për këtë pikë nuk qëndron.

Në përfundim mendojmë se pretendimet e operatorit ekonomik "Trinity Trade Company" sh.p.k. për këtë procedurë nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik "SLSI-AL" sh.p.k i shpallur fitues nga rivlerësimi i bërë nga KVO i datës 15.07.2019, ka plotësuar ofertën dhe kriteret e kualifikimit në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit.

II.7. Në datën 30.07.2019 operatorit ekonomik "Trinity Trade Company" shpk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 7022/1 prot., datë 08.08.2019, protokolluar me tonën në datën 13.08.2019 me objekt "Dërgim Informacioni " është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Trinity Trade Company" shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë "SI.SI-AL" shpk, me arsyetimin se: "I- Në DT, kërkesat e veçanta për kualifikim, pika 2.1 f, kërkohet: "d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatorit ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri."

a) Operatorit ekonomik "SI.SI-AL" shpk nuk e plotëson këtë kërkesë sipas ligjit, dhe përcaktimit të mësipërm, pasi dokumenti i paraqitur nga ky OE, nuk tregon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të fundit (Prill 2019), të energjisë elektrike,



b) Operatori ekonomik "SI.SI-AL" shpk nuk e plotëson këtë kërkesë sipas ligjit, dhe përcaktimit të mësipërm, pasi dokumenti i paraqitur nga ky OE, nuk tregon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të fundit (Prill 2019), të energjisë elektrike për kontratat e këtij operatori ekonomik sipas të gjitha vendeve të ushtrimit të aktivitetit të shënuara në ekstraktin e QKB-së.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 "Kriteret e Vecanta për Kualifikim" pika 2.1.f të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*"1. Ofertuesi duhet të dorëzojë: f. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri."*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik "SI.SI-AL" sh.p.k në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

*Vërtetim debie nr. 11088/1 prot., datë 24.05.2019, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit... vërtetohet se kërkuesi SI.SI-AL shpk nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën /kontratat (me kod) XXXXXXXXXX titullar dhe përdorues i së cilës/cilave është RS&M shpk, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 23.05.2019 duke përfshirë faturën koherente të muajit Prill 2019.*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit."*

III.1.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 27, pika 5, gërma "c", përcaktohet se: *"Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: "c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik."*

III.1.5. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.”.

III.1.6. Referuar korrespondencës që Komisioni i Prokurimit Publik ka pasur me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, është vënë në dijeni nga kjo e fundit, se pasi bëhen verifikimet përkatëse lëshohet “Vërtetim Debit” sipas formatit standard për të gjitha subjektet aplikuese.

“[...] Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike lëshon vërtetimet e debisë, bazuar në deklaratimet vullnetare të subjekteve kërkues të kontratave të energjisë elektrike. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike evidenton saktësinë e dokumentacionit të paraqitur si më poshtë:

1. Tërësinë e kontratave të deklaruara nga subjekti (në rast se mund të ketë kontrata të tjera të padeklaruara).
2. Kontratat e furnizimit për objektet e tyre, duhet të jenë të tarifuar si private.
3. Kontratat e furnizimit duhet të jenë në emër të subjektit, përvec rasteve kur ato janë ambiente të marra me qira.

Në rast se subjekti ka paraqitur kontrata familiare, Operatori i kërkon këtij të fundit ndryshimin e tarifimit dhe pagesën me faturën e ardhshme të diferencës së cmimit bazuar në legjislacionin në fuqi dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike. Të gjithë operatorët që kërkojnë të pajisen me Vërtetimin e Debit duhet të aplikojnë pranë Qendrave të KNK në të gjithë Shqipërinë dhe lëshimi do të jetë i mundur jo më vonë se pesë ditë pas kërkesës nga subjekti. Mosplotësimi i kriterëve të mësipërme do të rezultojë me moslëshimin e Vërtetimit të Debit nga Drejtoria Qendrore ose Drejtoritë Rajonale. Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debit në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur:

1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit.
2. Konsumatori rezulton debitor.
3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste.
4. konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së.
5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë. [...]

III.1.7. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përmes dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “SI.SI-AL” sh.p.k vërteton se ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit përkatësisht 06.06.2019 dhe Nenit 9, paragrafi 1 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, operatori ekonomik “SI.SI-AL” sh.p.k ka përmbushur detyrimet ligjore për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike. KPP gjykon se institucioni i OSHEE-së menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të

energjisë elektrike për të gjithë kontratat e lidhura midis OSHEE-së dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike.

III.1.8. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: *“Operatori ekonomik “SI.SI-AL” shpk nuk e plotëson këtë kërkesë sipas ligjit, dhe përcaktimit të mësipërm, pasi dokumenti i paraqitur nga ky OE, nuk tregon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të fundit (Prill 2019), të energjisë elektrike për kontratat e këtij operatori ekonomik sipas të gjitha vendeve të ushtrimit të aktivitetit të shënuara në ekstraktin e QKB-së.”*, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik *“SI.SI-AL” shpk* ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike një vërtetim, sipas formatit të miratuar, me anë të së cilës vërtetohet se subjekti *“SI.SI-AL” shpk* nuk rezulton debitor për kontratat e sipërcituara, përfshirë edhe muajin e fundit të maturuar referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe Vendimit të ERE nr.109, datë 21.10.2011 *“Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”*. KPP gjykon se Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Sh.a është institucioni i ngarkuar me akt nënligjor për lëshimin e vërtetimit të debisë për personat fizikë dhe juridikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim (OSHEE Sh.a), nr. 1081/1 prot., me objekt: *“Kthim përgjigje kërkesës për informacion”*, për dijeni Komisionit të i Prokurimit Publik, OSHEE sh.a. ndër të tjera sqaron se: *“Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debisë në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur: 1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit. 2. Konsumatori rezulton debitor. 3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste. 4. Konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së. 5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë.”*. KPP gjykon se institucioni i OSHEE-së menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të energjisë elektrike për të gjithë kontratat e lidhura midis OSHEE-së dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues *“Trinity Trade Company” shpk* për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë *“SI.SI-AL” shpk*, me arsyetimin se: *“Operatori ekonomik “SI.SI-AL” shpk, me dokumentacionin e paraqitur, nuk e plotëson këtë kërkesë sipas Ligjit dhe DT, sepse:*

a) *Në furnizimet e paraqitura nga ky OE, nuk ka artikuj të ngjashëm me ato të preventivit të këtij tenderi në vlerën e kërkuar nga AK.*

b) *Artikujt të konsideruar të ngjashëm, pjesë e kontratave apo faturave të paraqitura nga ky operator ekonomik nuk e plotësojnë vlerën e kërkuara nga AK, prej 40% të fondit limit.*

*Ftojme anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA-së), të caktuar nga Titullari i autoritetit kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 *“Kriteret e Vecanta për Kualifikim”* pika 2.3.1 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë: *“2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të*

fundit. Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se 700 000 leke pa tvsh (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje nga dokumentat e meposhtem:

- a. Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.

III.2.2. Objekti i prokurimit është: “Blerje bojë sinjalistike horizontale dhe dylen”.

III.2.3. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike konstatohet se operatori ekonomik ankimues “SI.SI-AL” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Fatura Tatimore Shitje nr. Serial: xxxxx, datë 15.11.2017, me përshkrim “Punime sipas situacionit bashkalidhur”, për shoqërinë “Modeste” shpk, me vlerë 19239,46 Euro ose 2.570.389 lekë pa-TVSH, ku në situacionin bashkalidhur janë këto zëra.:

Nr	Pershkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera	TVSH	Totali
1	Tabela STOP A60	cope	405.6	26	338	67.6	405.60
2	Tabela Ø 60	cope	410.4	18	342	68.4	410.40
3	Tabela A 90	cope	22.8	19	19	3.8	22.80
4	Tabela 60x60	cope	844.8	32	704	140.8	844.80
5	Tabela 40x60	cope	33.6	28	28	5.6	33.60
6	F.V Ishullor i verdhe	cope	134.4	28	112	22.4	182.40
7	F.V Sy mace	cope	816	6.8	680	136	816.00
8	F.V Tub 3 ml	cope	576	20	480	96	576.00
9	F.V Tub 3.6 ml	cope	414	23	345	69	414.00
10	F.V Tub 2.5 ml	ml	86.4	18	72	14.4	86.40
11	F.V vije e nderprere me boje bicomponente Spray 15 cm	ml	2271.456	0.88	1892.88	378.576	2271.456
12	F.V vije e plote me boje bicomponente Spray 15 cm	m2	7488.432	1.02	6240.36	1248.072	7488.432
13	F.V vije me boje bicomponente Spray e bardhe Pedonale+zëbrim	m2	2692.8	6.8	2244	448.8	2692.8

14	F.V vije me boje bicomponente Spray e kuqe Pedonale+zebrim	cope	3286.8	8.3	2739	547.8	3286.8
15	F.V vije me boje bicomponente Spray e bardhe shigjeta cift ne toke	cope	159.6	19	133	26.6	159.6
16	F.V vije me boje bicomponente Spray e bardhe shigjeta cift ne toke	m2	324	10	270	54	324
17	F.V vije me boje bicomponente Spray e bardhe kalim bicikleta	m2	81.6	6.8	68	13.6	81.6
18	F.V vije me boje bicomponente Spray e e verdhe Parkim invalid	m2	164.16	7.6	136.8	27.36	164.16
19	F.V vije me boje bicomponente Spray e bardhe kalim kembesor	m2	971.04	6.8	809.2	161.84	971.04
20	F.V vije me boje bicomponente Spray e bardhe zebrim (Ishuj)	m2	1689.12	6.8	1407.6	281.52	1689.12
21	F.V vije me boje bicomponente Spray e verdhe zebrim	m2	31.92	7.6	26.6	5.32	31.92
22	F.V shenja ne toke (trekendesha perpariesie, shenja invalidi)	cope	134.4	2	112	22.4	134.4
<b>SHUMA</b>					<b>19239,44</b>	<b>3847,89</b>	<b>23087,33</b>

III.2.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.2.5. Në nenin 27, pika 3 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “Kontratat e Mallrave”, parashikohet se *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”*.

III.2.6. Në nenin 27, pika 4 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor*

*kërkon: - Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. - Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.2.7. KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.8. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me fushën e veprimtarisë së objektit të prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Sa më sipër, autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara.

III.2.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "SI.SI-AL" sh.p.k. në përmbushje të kriterit për eksperiencë të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, faturat tatimore të shitjes të dorëzuara nga kjo shoqëri konsiderohen të ngjashëm me objektin e prokurimit, pasi dëshmojnë se ka furnizuar dhe vendosur bojë bikomponente gjatë tre viteve të fundit në vlerën e kërkuar në kriterin kualifikues të dokumentave të tenderit. Komisioni gjykon se krahasueshmëria e dëshmive të mëparshme nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e dëshmisë së mëparshme nëse ajo është një kontratë mallrash apo kontratë shërbimi/pune publike etj, por duhet parë në lidhje me zërat konkretë të dëshmive të mëparshme të furnizuara. Në rastin konkret, pavarësisht se dëshmia e mëparshme është punë publike me objekte më të gjëra veprimtarie, në zbatimin e këtyre punimeve ka patur furnizime të ngjashme me artikujt objekt prokurimi. Gjithashtu, KPP gjykon se për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për furnizime të ngjashme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin kontrata të ngjashme/fatura me objektin që prokurohet dhe jo kontrata/fatura të njëjta, pasi në këtë rast do të quheshin kontrata të njëjta ato

kontrata që përmbajnë të gjitha zërat që përmban preventivi që tenderohet, gjë e cila është pothuajse e pamundur, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me furnizime objekt prokurimi, por edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Gjithashtu vlen të theksohet se vlera e përgjithshme e furnizimeve të ngjashme të realizuara në kontratat e paraqitura nga ky operator ekonomik, e tejkalon vlerën prej 700,000 lekë pa-TVSH të vendosur nga autoriteti kontraktor në kriterin kualifikues të dokumentave të tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik “SI.SI-AL” sh.p.k e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, në pikën 2.3.1 të shtojcës 8, “Për kapacitetin teknik” në dokumentat standarte të tenderit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Trinity Trade Company” shpk nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Trinity Trade Company” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë “SI.SI-AL” shpk, me arsyetimin se: “Operatori ekonomik “SI.SI-AL” shpk, nuk plotëson një ndër kërkesat kryesore për kualifikim, konkretisht pikeën 2.1.1 a, të kritereve të veçanta për kualifikim, ku kërkohet: “Objekti i veprimtarisë së QKB duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.”.

Ky operator ekonomik, sipas Ekstraktit të QKB-së, nuk ka të përfshirë në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit (bojra).”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta për Kualifikim” pika 2.1.a të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë: “a. Objekti i veprimtarisë së QKB duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.”.

III.3.2. Objekti i prokurimit është: “Blerje bojë sinjalistike horizontale dhe dylen”.

III.3.4. Në shtojcën 9, “Specifikimet teknike”, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

## **Shtojca 9**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

#### **Specifikime Teknike per “Blerje bojë sinjalistike horizontale dhe dylen”**

Te dhenat teknike te bojes se sinjalistike horizontale:

Te pesta ngjyrat (e bardhe, e verdhe, blu, kuqe, jeshile) kane te njejtat specifikime teknike:

- PESHHA: 1.56 +- 0.02 gr/cm<sup>3</sup>
- VISKOZITETI; 70-80 KU (25 °C)
- PERHAPIA: 1.71 m<sup>2</sup>/kg-DFT 200µm
- THARJA: MAXIMUMI 25 min
- E GATSHME PER PERDORIM

**Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.**

*Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:*

**KUJDES**

*Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.*

III.3.5. Ndërsa në shtojcën 10, “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

**Shtojca 10**

*[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]*

**SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

*Sasia e mallit që kërkohet:*

<i>Nr</i>	<i>Emertimi I materialit</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>
<i>1</i>	<i>Boje fosforeshente e Bardhe</i>	<i>Kg</i>	<i>2000</i>
<i>2</i>	<i>Boje fosforeshente e Verdhe</i>	<i>Kg</i>	<i>400</i>
<i>3</i>	<i>Boje fosforeshente Blu</i>	<i>Kg</i>	<i>100</i>
<i>4</i>	<i>Boje fosforeshente e Kuqe</i>	<i>Kg</i>	<i>100</i>
<i>5</i>	<i>Boje fosforeshente Jeshile</i>	<i>Kg</i>	<i>300</i>
<i>6</i>	<i>Dylent</i>	<i>Litra</i>	<i>400</i>

**Afatet e lëvrimit:**

*Afati i levrimit do te jete sipas kerkesave dhe nevojave qe do te kete institucioni, por jo me vone se data 31.12.2019*

III.3.6. Nga verifikimi i kryer në Sistemin e Prokurimeve Elektronikë (SPE), konstatohet se operatori ekonomik ankimues “SI.SI-AL” sh.p.k ka dorëzuar ekstraktin historik të regjistrit tregtar ku në pikën 9 të tij parashikohet objekti i aktivitetit të subjektit si më poshtë:



*“Projektim-zbatim ne fushen e ndertimit.Import-eksport, tregti e mallrave te ndryshme me shumice dhe pakice.Projektimzbatim, sinjalistike rrugore horizontale dhe vertikale, ndricuese dhe jondricuese barriera dhe mbrojtje rrugore. Punime dhe projektme ne fushen e ndertimit: civile, industriale energjitike, ekonomike. Punime montimi dhe teknologjike.Projektme dhe studime te ndryshme ne fushen e ndertimit dhe sinjalistikes rrugore. Import-export dhe prodhim te bojrave.”.*

III.3.7. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”.*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.3.8. Në nenin 27, “Kontratat e mallrave” pika 3 e VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.*

III.3.9. KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

III.3.10. Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Trinity Trade Company” sh.p.k., nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “SI.SI-AL” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në Ekstraktin Historik të Regjistrit Tregtar për të Dhënat e Subjektit “SI.SI-AL” sh.p.k., është përcaktuar shprehimisht objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie: *“Projektim-zbatim ne fushen e ndertimit.Import-eksport, tregti e mallrave te ndryshme me shumice dhe pakice.Projektimzbatim, sinjalistike rrugore horizontale dhe vertikale, ndricuese dhe jondricuese barriera dhe mbrojtje rrugore. Punime dhe projektme ne fushen e ndertimit: civile, industriale*

*energjitike, ekonomike. Punime montimi dhe teknologjike. Projektme dhe studime te ndryshme ne fushen e ndertimit dhe sinjalistikes rrugore. Import-export dhe prodhim te bojrave”.*

Pra sa më sipër, KPP konstaton se shoqëria “SI.SI-AL” sh.p.k ka në objektin e veprimtarisë së tij tregëtimin e bojrave, pasi referuar objektit të veprimtarisë sa më sipër, fusha e veprimtarisë në të cilën operon operatori ekonomik është në përputhje me objektin e prokurimit që autoriteti kontraktor kërkon të realizojë, ndaj dhe Komisioni gjykon se operatori ekonomik “SI.SI-AL” sh.p.k është në kushtet e përmbushjes së kriterëve të kualifikimit e rrjedhimisht kualifikimi i tij në procedurën e prokurimit është i drejtë.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Trinity Trade Company” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë “SI.SI-AL” shpk, me arsyetimin se: “. Operatori ekonomik “SI.SI-AL” shpk, nuk plotëson kërkesat për kualifikim, konkretisht pikën 2.3.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim, ku kërkohet: “Çertifikatë e menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015 për objektin që prokurohet (e cila duhet të jetë e përkthyer në shqip dhe e noterizuar).”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta për Kualifikim” pika 2.3.2 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë: “2.3.2 Çertifikate e menaxhimit te cilesise ISO 9001-2015 per objektin qe prokurohet (e cila duhet te jene e perkthyer ne shqip dhe e noterizuar)”.

III.4.2. Objekti i prokurimit është: “Blerje bojë sinjalistike horizontale dhe dylen”.

III.4.3. Në shtojcën 9, “Specifikimet teknike”, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

## **Shtojca 9**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

*Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:*

#### **Specifikime Teknike per “Blerje bojë sinjalistike horizontale dhe dylen”**

*Te dhenat teknike te bojes se sinjalistike horizontale:*

*Te pesta ngjyrat (e bardhe, e verdhe, blu, kuqe, jeshile) kane te njejtat specifikime teknike:*

- PESHHA: 1.56 +- 0.02 gr/cm<sup>3</sup>
- VISKOZITETI; 70-80 KU (25°C)
- PERHAPIA: 1.71 m<sup>2</sup>/kg-DFT 200µm
- THARJA: MAXIMUMI 25 min
- E GATSHME PER PERDORIM

***Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.***

*Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:*

## **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

III.4.4. Ndërsa në shtojcën 10, “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

### **Shtojca 10**

*[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]*

#### **SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

Sasia e mallit që kërkohet:

<i>Nr</i>	<i>Emertimi I materialit</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>
1	Boje fosforeshente e Bardhe	Kg	2000
2	Boje fosforeshente e Verdhe	Kg	400
3	Boje fosforeshente Blu	Kg	100
4	Boje fosforeshente e Kuqe	Kg	100
5	Boje fosforeshente Jeshile	Kg	300
6	Dylent	Litra	400

#### **Afatet e lëvrimit:**

Afati i levrimit do të jete sipas kerkesave dhe nevojave qe do te kete institucioni, por jo me vone se data 31.12.2019

III.4.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ankimues “SI.SI-AL” sh.p.k, ka dorëzuar:

Certifikatë ISO 9001:2015 me nr.SB13.0388.01.QMS, për objektin: “Realizim dhe vendosja e sinjalistikes rrugore vertikale. Zbatim i sinjalistikes horizontale. Vendosja e barrierave mbrojtese dhe sigurise rrugore”, lëshuar nga organizimi certifikues Certi E<sup>r</sup>, për operatorin ekonomik “SI.SI-AL”, sh.p.k. në gjuhën italiane, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar.

III.4.6. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që

*do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”.*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.4.7. Në nenin 30 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet: *“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” 1. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”*

III.4.8. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt prokurimi sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes së certifikatës ISO 9001:2015. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ankimues “SI.SI-AL” sh.p.k., ndër të tjera, për të vërtetuar se kryen aktivitetin e tij sipas standarteve të menaxhimit të cilësisë ka paraqitur certifikatën ISO 9001:2015 me nr. SB13.0388.01.QMS, lëshuar nga organizimi certifikues Certi E<sup>f</sup>. Nga shqyrtimi i kësaj certifikate, rezulton se operatori ekonomik ankimues është certifikuar për menaxhimin e cilësisë sipas standartit ISO 9001:2015 për aktivitetet: *“Realizim dhe vendosja e sinjalistikes rrugore vertikale Zbatim i sinjalistikes horizontale. Vendosja e barrierave mbrojtese dhe sigurise rrugore”*. Në këto kushte, Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimues arrin të vërtetojë se kryen aktivitetin objekt prokurimi sipas standartit ISO 9001:2015 pasi me anë të certifikatës të sipërcituar, ankimuesi vërteton se është i certifikuar për menaxhimin e cilësisë për shërbime të cilat janë të ngjashme me objektin e prokurimit.

Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik ankimues “SI.SI-AL” sh.p.k., me dokumentacionin e paraqitur, e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8, pika 2.3.2, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së

prokurimit objekt ankimi, pasi vërtetohet se është i certifikuar për menaxhimin e cilësisë sipas standartit ISO 9001:2015 të ngjashëm me objektin e prokurimit.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Trinity Trade Company” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-23517-05-23-2019, me objekt: “Blerje bojë sinjalistike horizontale dhe dylen”, me fond limit 1.860.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 06.06.2019, nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Fier.
  2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës.
  3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
  4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 1333 Protokoll; Datë 30.07.2019**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**